

VENDIM
Nr. 461, datë 19.6.2026

PËR PËRFUNDIMIN E SITUATËS SË VEÇANTË NË TREGUN E
HIDROKARBUREVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21/1, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfundimin e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve në territorin e Republikës së Shqipërisë, shpallur si të tillë me vendimin nr. 186, datë 19.3.2026, të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 21/1, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Pushimin e veprimtarisë së Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit, i cili u ngrit dhe funksionoi gjatë periudhës së situatës së veçantë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe subjektet e licencuara për veprimtari me shumicë e pakicë në tregun e hidrokarbureve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama